



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3755/ 6 prot.

Datë 22/01/2025

V E N D I M

Nr. 117/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22/01/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ilirjana Qoku” PF në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30027-11-19-2024, me objekt “Blerje Softëare për burimet njerëzore”, me fond limit 4,286,200 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana SHA.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ilirjana Qoku” PF me NIPT M21403009A, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga “Hajdar Hidi”, Zona Kadastrale 8380, Numër Pasurie 4/139, Zk. 8380, vol. 23, faqe. 145, Kati Parë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Eco Tirana SHA
Adresa: Rruga “Don Bosko”, ish parku i autobusave, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.11.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30027-11-19-2024, me objekt “Blerje Softëare për burimet njerëzore”, me fond limit 4,286,200 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana SHA.

II.2. Në datë 02.12.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 06.12.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Ilirjana Qoku”	2.889.000 leke skualifikuar
2. “BIS BUSINESS INTEGRATION SOLUTIONS”	3.240.000 leke kualifikuar
3. “QuantX IT Solutions”	3.600.000 leke kualifikuar
4. “Coders”	3.600.000 leke kualifikuar

II.4. Në datën 06.12.2024, operatori ekonomik “Ilirjana Qoku” P.F është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik ne formularin e shtojces 10.Pjesa e II Shkaqet e perjashtimit Pika A Paragrafi i III Nuk ka deklaruar: Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin 2.2.1 pasi nuk ka paraqitur deklaratën për xhiron vjetore sipas kërkesës së AK. Operatori ekonomik nuk ka dorezuar dokumentacionin sipas kërkesës 2.3.2. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për personelin e kërkuar: Kontratë Pune e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, Diplomë universitare për punonjësit me profil ekonomik dhe për atë programues dhe Çertifikim përkatës për trajnuesin për programin e ofertuar. Operatori ekonomik nuk ka dorezuar deklaratën sipas pikes 2.4.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të ofrojë shërbim asistence përgjate të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 16.12.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e prokurimit, duke shpallur fitues ofertën e operatorit ekonomik **“BIS BUSINESS INTEGRATION SOLUTIONS”** SHPK.

II.6. Në datën 24.12.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4925, datë 24.12.2024, dhe me nr. 3755/2024 prot, datë 26.12.2024, të operatorit ekonomik **“Ilirjana Qoku”** PF, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 **“Veprimet paraprake”** të Ligjit nr.162/2020 **“Për Prokurimin Publik”**, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3755/2, datë 26.12.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **“Ilirjana Qoku”** PF, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 667/8 prot, datë 27.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3755/3 prot, datë 30.12.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe informacioni lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues **“Ilirjana Qoku”** PF, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar se ankesa është paraqitur jashtë afateve ligjore.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në datë 24.12.2024, me nr. 3755/2024 prot, datë 26.12.2024 dhe nr. ankimi elektronik A/2024/4925 nga operatori ekonomik “Ilirjana Qoku” PF, për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 20.11.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30027-11-19-2024, me objekt “Blerje Softëare për burimet njerëzore”, me fond limit 4,286,200 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana SHA.

III.1.2. Në datë 02.12.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 06.12.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Ilirjana Qoku”	2.889.000 leke skualifikuar
2. “BIS BUSINESS INTEGRATION SOLUTIONS”	3.240.000 leke kualifikuar
3. “QuantX IT Solutions”	3.600.000 leke kualifikuar
4. “Codiers”	3.600.000 leke kualifikuar

III.1.4. Në datën 06.12.2024, operatori ekonomik “Ilirjana Qoku” P.F është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik ne formularin e shtojces 10.Pjesa e II Shkaqet e perjashtimit Pika A Paragrafi i III Nuk ka deklaruar: Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin 2.2.1 pasi nuk ka paraqitur deklaratën per xhiron vjetore sipas kërkesës se AK. Operatori ekonomik nuk ka dorezuar dokumentacionin sipas kërkesës 2.3.2. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për personelin e kërkuar: Kontratë Pune e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, Diplomë universitare për punonjësit me profil ekonomik dhe për atë programues dhe Çertifikim përkatës për trajnuesin për programin e ofertuar. Operatori ekonomik nuk ka dorezuar deklaratën sipas pikes 2.4.3. Operatori ekonomik duhet te deklaroje se do te ofroje sherbim asistence pergjate te gjithe periudhes se zbatimit te kontrates.”.

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 16.12.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e

prokurimit, duke shpallur fitues ofertën e operatorit ekonomik “*BIS BUSINESS INTEGRATION SOLUTIONS*” SHPK.

III.1.6. Në datën 24.12.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4925, datë 24.12.2024, dhe me nr. 3755/2024 prot, datë 26.12.2024, të operatorit ekonomik “*Ilirjana Qoku*” PF, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3755/2, datë 26.12.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Ilirjana Qoku*” PF, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.8. Me shkresën nr. 667/8 prot, datë 27.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3755/3 prot, datë 30.12.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe informacioni lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Ilirjana Qoku*” PF, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar se ankesa është paraqitur jashtë afateve ligjore.

III.1.9. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i Prokurimit Publik*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij*”.

III.1.10. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.11. Në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në nenin 112, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”

Në nenin 115, pika 1 dhe 3 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur

si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji; b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimin të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.12. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak (16.12.2024), ka qenë data 23.12.2024. Në këtë kuadër, ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datë 24.12.2024, pra jashtë afateve të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar jo më vonë se në datën 23.12.2024, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike”. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 2 e LPP i cili

parashikon, se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak 16.12.2024 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret data e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak është 16.12.2024 ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi në autoritetin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, është data 24.12.2024, jashtë afatit 7 (shtatë) ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit 113 njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret vërtetohet, se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimimit. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Ilirjana Qoku*” PF nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Ilirjana Qoku*” PF në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-30027-11-19-2024, me objekt “*Blerje Softëare për burimet njerëzore*”, me fond limit 4,286,200 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana SHA.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Ilirjana Qoku*” PF.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

